

## **Letërsia shqipe më e bukur do të udhëtojë Bisedë me albanologun Robert Elsie**

Kur njihesh me Robert Elsie, në fillim fare s'çuditesh dhe aq. Një fytyrë njeriu e përzemërt, e qeshur (por trishtimi se ku është diku thellë, mbase është dhimbja për çdo gjë në botë) ka sy të vëmendshëm, zhbirues. Më tepër të dëgjon, por ajo që thotë është gjithmonë e vërtetë dhe e sigurtë. Bashkëbiseduesi i rastësishëm befaz çuditet me të që s'qënkërka shqiptar, por kanadez, edhe pse e flet gjuhën tonë shkëlqyeshëm. Jo vetëm kaq, por ai e njih letërsinë shqipe të tërën, që nga fillimet. E jo vetëm kaq, ai është dhe historian dhe përkthyes dhe interpretues i saj nëpër botë. Ka ardhur disa herë në Shqipëri. Miqtë e tij janë të shumtë këtu e në Kosovë ku është dhe anëtar nderi i shoqatës së shkrimtarëve atje.

[VZh]: “Kur e dëgjuat për herë të parë Shqipërinë dhe ç'ju tërheq ajo?” e pyes.

[RE]: “Që djalë, kur koleksionoja pulla. Gjeta njëren me portret të Viktor Emanuelit. Pra ishit të pushtuar. Pastaj vonë mësova se kishit një politikë të çuditshme kundër gjithë botës. Dëgjoja radion ‘Ju flet Tirana’ anglisht, një propagandë absurde e qesharake. Ndjekësia rebel,” tregon Roberti në një intervistë në Kosovë, “dhe s'desha të bëj atë që bënin shokët e mij. Ata studionin gjuhët e ‘mëdha,’ frëngjisht, gjermanisht, rusisht, spanisht. Pak të huaj merren me shqipen dhe ju ktheva asaj.” Sepse Robert Elsie ka mbaruar për filologji klasike (njeh gjithë gjuhët indoevropiane). Për gjuhët krahasimtare studioi në Francë, Irlandë e Gjermani ku dhe banon.

[VZh]: “E shqipen ku e mësuat?”

[RE]: “Vetë, autodidakt. Së pari gjuha shqipe është e vështirë dhe e dyta s'kisha me kë të flisja. M'u dha rasti në Paris, me një vajzë në metro që lexonte Mao Ce Dunin. Vetëm dy minuta nën tokë dhe mësova rrezikun e teorisë së tre botëve. Pastaj bleva literaturë. Më 1978 erdha për herë të parë nga Universiteti i Bonit, disa muaj mbas prishje me Kinën, me ftesë nga Akademia. Desha të dëgjoj shqip. S'jam i zhgënyer nga letërsia shqipe. Është puna e një jete. Ka plot libra të mërziqshëm, por gjen dhe xhevahirë. Dua të flas për Fishtën që u munduan të harrohej. Është poet i mrekullueshëm, me vlera të pafundme. Naimi është poet kombëtar, mbase s'ka nevojë për të tillë, por Fishta është madhështor. Isha në Shkodër tani, me delegacionin që kemi ardhur. Pamë përmbajtjen. E dhimbëshme. 7 herë na u prish makina. Morëm taksì dhe u kthyem me autobuz. Qe një mrekulli. Udhëtarët recitonin Fishtën, jo për mua, s'dinin gjë, por për veten e tyre. Sikur më ranë rreze dielli mu duk. Shqipëria ka shumë burime letrare të humbura. Poezia me frymë myslimane është shumë interesante, mbase vetëm Spanja e ka një të tillë, por s'ka specialistë që të lexojnë shqip me gërma arabe. Ky kapitull ka mbetur i zbrazët.

Në një nga librat e mi e krahasoj letërsinë shqipe me një pemë dhe shpesh ju i keni vetëm lulet asaj, por edhe rrënjët. Janë në shkëmb. Letërsia e vjetër me Bogdanin është një kulm. Me ardhjen e turqëve ajo letërsi e Veriut u prish. Vazhduan bejtexhinjtë. Shekulli XIX ju gjeti të kthyer nga Europa.

Së treti, vitet '35-'40 janë të letërsisë më të zhvilluar shqipe që u prish me ardhjen e komunistëve, të cilët prishën dhe rrënjët. U bë letërsi socialiste pa baza e themele, njeriu i ri e letërsi e re. Një dështim. Por letërsia çuditërisht mbijeton dhe shkund gjithçka.”

[VZh]: “Të shumtë janë studimet, artikujt e reçensionet që botoni në shtypin perëndimor për letërsinë shqipe. Por ç’libra keni botuar andej?”

[RE]: “Në Nju-Jork, p.sh. para 5 vjetësh botova Leksikonin e Letërsisë Shqipe, ku u përfshinë 500 shkrimtarë. Pastaj kam botuar një antologji të poezisë në gjermanisht që fillon me Matrëngën e deri sot. Botova Migjenin para 4 vjetësh gjermanisht, dhe anglisht para 6 muajsh. Janë pritur shumë mirë nga të interesuarit. Nëse libri blihet pak sot në botë, ata janë shitur që të gjithë.”

[VZh]: “Jemi në rizbulime vlerash tonat, të ndaluara. E ju që i njihni shkëlqyer, keni ndonjë projekt për t’i bërë të njohura?”

[RE]: “Historinë e Letërsisë Shqipe që botohet në SHBA. Është e para e plotë e pa përjashtime. Është vepër voluminoze ku janë të futur dhe autorë nga më të fundit e të burgosur dikur. Gjithashtu antologjia e poezisë shqipe, del në Angli, në fund të vitit me ndihmën e UNESCO-s. Kam 25 autorë të sotshëm, fillon me dy themeluesit, Lasgushin dhe Migjenin, sepse Fishta s’krijoi letërsi të sotme. Pastaj janë Mekuli, Kadare, Agolli, Arapi, poetë të burgosur nga diktatura etj., më të njohurit këtu dhe në Kosovë ku bëhet poezi më e mirë. Ndërsa proza është ndryshe, më lart qëndron këtej.”

[VZh]: “Ju të mrekulloni me ato që dini për ne. Nëse do ju pyesja se kush jeni ju, ç’do spjegoni?”

[RE]: “S’e di kush jam. S’ka rëndësi” (e buzëqesh bukur me një xixëllimë sysh të mençur).

[VZh]: “Si ju duket vendi ynë tani?”

[RE]: “Gjithmonë, me çdo ardhje e gjej ndryshe Shqipërinë. Keq, pastaj më keq deri sa u arrit fundi. Tani po shoh përmirësime. Fillimi u bë. Mbase juve s’ju duket gjë njeriu që shet çokollata në rrugë. Dhe të mendosh në vendin ku shumë gjëra s’guxohej të ishin as ëndrra. Kështu nis. Pastaj vjen e madhja. Mbarësi në të gjitha!”

[VZh]: “Falemnderit për të gjitha.”

E intervistoi: Visar Zhiti.

[botuar në / published in: gazeta *Rilindja Demokratike*, Tirana, 16 dhejtor/December 1992.]